

HYRJE NË TRAJTIMIN E UJIT TË PIJSHËM

Përshkrimi i kursit

Në mënyrë që të ofrohet ujë i pijshëm dhe shërbim i sigurt për konsumatorët, uji do të kalojë në një sërë procesesh trajtimi. Këto procese reduktojnë ndotësit që gjenden në ujë si dhe përmirësojnë cilësinë e shijes dhe erës. Shoqëritë UK, vecanërisht operatorët dhe laborantët që punojnë në impiantet e trajtimit të ujit, si dhe ata që punojnë në prodhimin e tij, duhet të kenë njohuritë bazë të proceseve në të cilat uji kalon si dhe të operojnë dhe mirëmbajnë pajisjet në mënyrën e duhur.



Ky kurs trajnimi do të shpjegojë të gjitha proceset e trajtimit të ujit dhe kontrollet bazë që duhet të kryhen. Këtu përfshihen, procesesi i ajrimit, sedimentimit, flokulimit, filtrimit, mënyrat e dezinfektimit të ujit si dhe kontrolli i korrozionit, shijes dhe aromës.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për punonjësit dhe inxhinierët që punojnë në impiantin e trajtimit të ujit, inxhinierët e prodhimit, laborantët, dhe kimistët.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Shpjegoni procesin e ajrimit dhe të njihni llojet e ajruesve më të përdorshëm;
- Njihni rëndësinë e procesive të koagulimit dhe flokulimit;
- Rendisni llojet e koagulantëve;
- Shpjegoni procesin e sedimentimit;
- Shpjegoni procesin e filtrimit dhe të identifikoni llojet e filtrave;
- Përshkruani procesin e dezinfektimit dhe të identifikoni pikat e aplikimit të klorit;
- Njihni efektet negative të korrozionit dhe faktorët që ndikojnë në korrozion;
- Identifikoni shkaqet e shijes dhe të erës së keqe dhe parandaloni zhvillimin e erërave me anë të programit të monitorimit.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Hyrje në Trajtimin e Ujit". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me certifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.